



Në bazë të Nenit 50 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 5/02) dhe në lidhje me nenet 32 dhe 35 të Vendimit për transportin e linjave në qytetin e Shkupit ("Lajmëtari Zyrtar i Qytetit të Shkupit" numër 10/15, 17/15, 04/16, 08/16, 13/16, 02/17, 08/17, 06/18, 15/18, 16/18, 02/19, 04/22, 09/22 dhe 11/22), Kryetarja e Qytetit të Shkupit shpall:

**SHPALLJE PUBLIKE NR. 08- 2324/1  
PËR NDARJEN E PAKOVE TË LINJAVE PËR DHËNIEN E LEJEVE PËR TRANSPORTIN  
E LINJAVE TË UDHËTARËVE NË QYTETIN E SHKUPIT**

**1. LËNDA E SHPALLJES PUBLIKE**

1.1. Lëndë e shpalljes publike është ndarja e pakove – të linjave dhe dhënia e lejeve për realizimin e transportit të linjave të udhëtarëve në Qytetin e Shkupit, në pajtim me rrejetin e linjave të përcaktuara në Vendimin për transportin e linjave të udhëtarëve në qytetin e Shkupit (në tekstin e mëtutjeshëm: Vendimi).

1.2. Pakot e linjave me elementet minimale të nevojshme teknike – teknologjike për mirëmbajtjen e linjave në pajtim me elementet për mirëmbajtjen e linjave të përfshira në Vendimin, janë prezantuar në tabelat:

**Pakoja e linjave 1:**

Linja	Numri minimal i autobusëve	Numri minimal i vozitësve	Autobusë në rezervë	Vozitës në rezervë	Gjithsej autobusë	Gjithsej vozitës
23	12	28	3	8	15	36
45	10	20	3	6	13	26
61	2	3	1	1	3	4
63	2	6	1	2	3	8
73	1	2	0	0	1	2
<b>GJITHSEJ</b>	<b>27</b>	<b>59</b>	<b>8</b>	<b>17</b>	<b>35</b>	<b>76</b>

**Pakoja e linjave 2:**

Linja	Numri minimal i autobusëve	Numri minimal i vozitësve	Autobusë në rezervë	Vozitës në rezervë	Gjithsej autobusë	Gjithsej vozitës
9	12	24	3	7	15	31
11	4	8	1	2	5	10
11A	3	6	1	2	4	8
12	6	14	2	4	8	18
47A	1	3	1	1	2	4
55	4	9	1	3	5	12
<b>GJITHSEJ</b>	<b>30</b>	<b>64</b>	<b>9</b>	<b>19</b>	<b>39</b>	<b>83</b>

**Pakoja e linjave 3:**

Linja	Numri minimal i autobusëve	Numri minimal i vozitësve	Autobusë në rezervë	Vozitës në rezervë	Gjithsej autobusë	Gjithsej vozitës
19	12	25	3	8	15	33
20	8	18	2	5	10	23
22	8	16	2	5	10	21

52	2	5	1	2	3	7
54	2	2	1	1	3	3
<b>GJITHSEJ</b>	<b>32</b>	<b>66</b>	<b>9</b>	<b>21</b>	<b>41</b>	<b>87</b>

1.2.1. Linja e pakove në pikën 1.2. me numër 9, 19, 22, 52, 61 dhe 63 do të shërbehet bashkërisht nga transportuesi i përzgjedhur sipas kësaj shpalljeje publike dhe nga Ndërmarrja e qarkullimit publik "Shkup" – Shkup.

1.3. Ndarja e pakove – linja të përcaktuara në pikën 1.2 të kësaj shpalljeje do të realizohet nëpërmjet vlerësimit të aplikimeve të plota dhe të mbyllura dhe të dorëzuara në kohë, bazuar në kriteret e përcaktuara të theksuara në dokumentacionin për shpalljen publike.

1.4. Hapja e aplikimeve të mbyllura të dorëzuara do të bëhet më datë 27 mars 2023 në orën 12:00 në barakën nr. 13.

1.5. Pakoja e linjave të përcaktuara në pikën 1.2. nga kjo shpallje jepet për një periudhë deri në 2 (dy) vite, me mundësi të vazhdimit të afatit, por jo më shumë se 5 (pesë) vite.

1.6. Procedurën për ndarjen e pakove të linjave dhe për dhënien e lejeve për realizimin e transportit të linjave të udhëtarëve në qytetin e Shkupit do ta zbatojë Komisioni i formuar nga kryetari i Qytetit të Shkupit.

1.7. Pas përfundimit të procedurës, kryetarja e Qytetit merr aktvendim për çdo linjë të pakos së ndarë. Qyteti i Shkupit dhe aplikanti i përzgjedhur lidhin kontratë, e cila është pjesë përbërëse e dokumentacionit për shpalljen publike.

## 2. ORARI I QARKULLIMIT

2.1. Oraret e qarkullimit të linjave që janë lëndë e shpalljes publike, si dhe certifikatat nga oraret e përcaktuara të qarkullimit të theksuara në pikën 1.2.1. të kësaj shpalljeje përcaktohen në dokumentacionin për shpallje publike (Shtojca nr. 2)

## 3. KUSHTET DHE MËNYRA E APLIKIMIT

### 3.1 E DREJTA PËR PJESËMARRJE NË SHPALLJEN PUBLIKE

3.1.1 Të drejtën e pjesëmarrjes në shpalljen publike për ndarjen e paketave të linjave dhe për dhënien e lejeve për realizimin e transportit të linjave të udhëtarëve në Qytetin e Shkupit për pakon e ndarë e kanë transportuesit - persona juridikë dhe tregtarë individualë, individualisht ose të organizuar në grup, që plotësojnë kushtet e përcaktuara në dokumentacionin për shpalljen publike dhe të cilët do të dorëzojnë garanci bankare ose të do të paguajnë depozitën bankare për pjesëmarrje në shpalljen publike.

3.1.2 Dokumentacioni për shpalljen publike mund të merret çdo ditë pune nga ora 08:30 deri në orën 16:30, në ambientet e Qytetit të Shkupit - Sektori për Komunikacion (baraka nr. 14), në Bul. "Ilinden" nr. 82. Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut, duke i bashkëngjitur vërtetimin për mjete të pakthyeshme të paguara (kompensimi për tërheqjen e dokumentacionit për shpallje publike) në shumën prej 4.000,00 (me fjalë: katër mijë) denarë.

Detajet e pagesës janë si më poshtë:

**Qëllimi:** Pagesa e dokumentacionit sipas shpalljes publike nr. 08-\_\_\_\_\_

**Emri i pranuesit:** Llogaria e thesarit

**Banka e pranuesit:** BPRM

**Llogaria e transaksionit:** 100000000063095

**Llogaria e shfrytëzuesit:** 785014123863012

**Shifra e të ardhurave:** 724125

**Programi:** 00

3.1.3 Personi që do të tërheq dokumentacionin për shpalljen publike duhet të dorëzojë një

autorizim të lëshuar nga personi juridik për të cilin tërheq dokumentacionin, duke specifikuar të gjitha informacionet e nevojshme kontaktuese (adresën, telefonin, faksin, e-mail) të personit juridik ose të personit të autorizuar nga personi juridik. Autorizimi dorëzohet personalisht me rastin e marrjes së dokumentacionit për shpalljen publike.

3.1.4 Të gjithë subjektet e interesuara që kanë tërhequr dokumentacionin për shpalljen publike, të dhëna më të detajuara dhe informata shtesë mund të marrin në Sektorin për Komunikacion baraka 14 - personi kontaktues: Aleksandar Stankovski, tel. 02/3297308; 02/3297310, e-mail: [Aleksandar.Stankovski@skopje.gov.mk](mailto:Aleksandar.Stankovski@skopje.gov.mk)

3.1.5 Dokumentet për plotësimin e kushteve për pjesëmarrje në procedurë dorëzohen në mënyrën e përcaktuar në dokumentacionin për shpalljen publike. Të dhënat e detajuara në lidhje me shpalljen publike përcaktohen në dokumentacionin për shpalljen publike.

## **3.2 VLERA E GARANCISË PËR PJESËMARRJE NË SHPALLJEN PUBLIKE**

3.2.1 Në kuadër të aplikacionit, aplikanti siguron garanci për pjesëmarrje në shpallje publike në formë të garancisë bankare ose të mjeteve të depozituara në shumën prej 20.000,00 (me fjalë: njëzet mijë) denarë.

3.2.2 Garancia bankare duhet të jetë e vlefshme për 90 (nëntëdhjetë) ditë nga dita e shënuar si afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve.

3.2.3 Garancia bankare dorëzohet në formë origjinale, kopjet nuk pranohen.

3.2.4 Mjetet në denarë duhet të deponohen në llogarinë vijuese:

Emri i pranuesit	Llogaria e thesarit
Banka e pranuesit	BPRM
Llogaria e transaksionit	100000000063095
Llogaria e shfrytëzuesit	785014123869613
Shifra e të hyrave	725939
Programi	00

3.2.5 Pas përfundimit të procedurës, garancia e pjesëmarrjes ose mjetet e depozituara u kthehen pjesëmarrësve në procedurë brenda 7 ditëve nga dita e lidhjes së kontratës me transportuesin e përzgjedhur.

## **3.3 VLERA E GARANCISË PËR REALIZIMIN CILËSOR TË KONTRATËS**

3.3.1 Si pjesë e aplikimit, aplikanti duhet të paraqesë deklaratë me shkrim se me lidhjen e mundshme të kontratës do të japë garanci për realizimin cilësor të kontratës në formën e një garancie bankare ose fondeve të depozituara në shumën 20,000.00 ( me shkronja: njëzet mijë) denarë për automjet, për të cilën posedon certifikatë licence për transport të linjës së udhëtarëve në qytetin e Shkupit.

3.3.2 Transportuesi i përzgjedhur me nënshkrimin e kontratës duhet të dorëzojë garancinë bankare ose mjetet e deponuara.

3.3.3 Pas sigurimit të garancisë bankare për përmbushjen cilësore të obligimeve nga kontrata ose deponimin e mjeteve, Qyteti i Shkupit do t'ia kthejë garancinë për pjesëmarrje ose mjetet e deponuara për pjesëmarrje në procedurë, transportuesit të përzgjedhur me të cilin do të lidhë kontratën.

## **4. AFATI PËR DORËZIMIN E APLIKIMEVE**

4.1. Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve për pjesëmarrje në shpalljen publike është data 21 mars 2023 deri në orën 12:00 me orën lokale.

4.2. Aplikimet dorëzohen në zarfe të mbyllura në arkivin e Qytetit të Shkupit (baraka nr. 16) në nr. bul. "Ilinden", nr. 82, Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut, me shënimin "Aplikim

për shpallje publike nr. 08-2324/1 për ndarjen e pakove të linjave nr.\_\_\_\_ dhe për dhënien e lejeve për transportin e udhëtarëve në qytetin e Shkupit".

4.3. Aplikanti dorëzon ekzemplarin origjinal të aplikimit me të gjithë dokumentacionin në një zarf të mbyllur ku:

- adresohet me adresën e saktë të Qytetit të Shkupit;
- në këndin e sipërm majtas qëndron paralajmërimi "Mos hap", në mënyrë që të mos hapet para orës dhe datës së hapjes së aplikimit;
- në mes të zarfit shënohet emërtimi i shpalljes publike.

4.4. Nëse zarfet nuk mbyllen dhe nuk janë shënuar ashtu siç parashikohet, Qyteti i Shkupit nuk mban përgjegjësi për mbërritjen e tyre të vonuar dhe të pakompletuar në arkivin e tij ose për hapjen e parakohshme.

4.5. Parashtruesi i aplikimit në asnjë rast nuk duhet të theksojë informacione në zarf me të cilat do të zbulohet identiteti i aplikantit.

4.6. Të gjitha aplikimet që do të dorëzohen në kundërshtim me këtë pikë do të vlerësohen si të parregullta dhe nuk do të shqyrtohen.

## **5. MËNYRA DHE PROCEDURA E VENDIMMARRJES**

5.1 Ndarja e pakos - linjave dhe dhënia e lejeve për kryerjen e transportit të linjave të udhëtarëve do të bëhet nëpërmjet vlerësimit të aplikimeve.

5.2. Kriteret për zgjedhjen e aplikimit më të favorshëm, mënyra dhe procedura janë dhënë më hollësisht në dokumentacionin për shpalljen publike dhe në përgjithësi do të vlerësohen sipas kriterëve të mëposhtme:

- Parku i automjeteve;
- Burime njerëzore;
- Logjistika teknike;
- Eksperiencia në kryerjen e transportit komunal të linjave të udhëtarëve.

5.3 Aplikimi më i favorshëm konsiderohet aplikimi me numrin më të madh të pikëve sipas kriterëve të përcaktuara në pikën 5.2, të cilat janë përcaktuar në mënyrë të hollësishme në dokumentacionin për shpalljen publike. Në rastin kur numri i pikëve është i njëjtë, aplikimi më i favorshëm konsiderohet aplikimi i ofruar nga aplikanti që ka numër më të madh pikësh nga Shtojca nr. 3 i Dokumentacionit për shpalljen publike - Kriteret për zgjedhjen e transportuesit të një pakete të caktuar të linjave, pika RK 1.2. Vjetërsia mesatare e parkut të automjeteve.

5.4 Shpallja publike konsiderohet e suksesshme nëse është dorëzuar të paktën një aplikim që i plotëson të gjitha kushtet dhe kërkesat e parashikuara në dokumentacionin për shpalljen publike, me ç'rast bëhet vlerësimi, dhe nuk kryhet vlerësimi dhe renditja e dokumentacionit të depozituar.

## **6. DITA, ORA DHE VENDI I HAPJES PUBLIKE TË APLIKIMEVE**

6.1 Hapja publike e aplikimeve do të bëhet më datë 27 mars 2023 në orën 12:00 në barakën nr. 13.

6.2 Kërkesa e dorëzuar brenda afatit të përcaktuar në përputhje me pikën 4.1 të shpalljes do të konsiderohet si aplikim në kohë.

6.3 Aplikimet e dorëzuara jashtë afatit të përcaktuar si dhe aplikimet të cilat nuk përmbajnë të dhënat e nevojshme të parashikuara me shpalljen publike nuk do të merren parasysh dhe pas vërtetimit të gjendjes i kthehen aplikantit.

6.4 Aplikimi nuk mund të ndryshohet, zëvendësohet ose tërhiqet pas afatit të fundit për dorëzimin e aplikimeve të parashikuara në pikën 4.1.

6.5 Para hapjes së aplikimeve, aplikanti ose përfaqësuesi i tij është i detyruar t'i dorëzojë Komisionit letërnjoftim ose pasaportë, si dhe autorizim me shkrim ose prokurë të noterizuar për përfaqësuesin. Hapja publike do të bëhet pavarësisht nga fakti nëse në hapje janë të pranishëm aplikanti apo personat e autorizuar

6.6. Procedura hapet nga Komisioni me përcaktimin e numrit të aplikimeve të pranuar dhe

emrat e transportuesve, numrin e aplikimeve të arritura në kohë dhe pas afatit të përcaktuar, vërtetimin e garancisë së bashkangjitur për pjesëmarrje në shpalljen publike në formën e garancisë bankare ose mjeteve të deponuara dhe identifikimin e përfaqësuesve të ofertuesve.

6.7 Komisioni fillon me hapjen e aplikimeve (sipas radhës së pranimit) dhe përcakton cilët aplikantë plotësojnë kushtet për pjesëmarrje të përcaktuara në këtë shpallje dhe dokumentacionin për shpalljen publike.

6.8 Gjatë hapjes së aplikimeve mbahet procesverbal.

6.9 Përfaqësuesit e pranishëm të aplikantit plotësojnë formularin për pjesëmarrje që është pjesë përbërëse e procesverbalit. Të gjithë të pranishmit njihen me përmbajtjen e procesverbalit. Përfaqësuesit e pranishëm të aplikantit mund të japin vërejtje për procedurën në një formular të veçantë që është pjesë përbërëse e procesverbalit.

## **7 PROCEDURA PAS PËRFUNDIMIT TË THIRRJES PUBLIKE**

7.1 Komisioni në një seancë të mbyllur, shqyrton në mënyrë të detajuar aplikimet dhe dokumentacionin që plotësojnë kushtet për pjesëmarrje në shpallje dhe në bazë të vlerësimit të kriterëve të përcaktuara, përgatit listën e renditjes për çdo pako linjash.

7.2 Për punën e tij, Komisioni përgatit Raport, me propozim për dhënien e lejes për linjat nga pakoja, të cilin ia dorëzon menjëherë Kryetares së Qytetit të Shkupit. Kryetarja e Qytetit të Shkupit sjell aktvendim për çdo linjë të pakos së caktuar. Aplikantët e pakënaqur kanë të drejtë ankimi kundër aktvendimit brenda tetë ditëve nga dita e marrjes së vendimit të ministrit të Transportit dhe Lidhjeve.

7.3 Qyteti i Shkupit dhe aplikanti i përzgjedhur do të lidhin marrëveshje në një afat prej 8 (tetë) ditësh nga dita e pranimit të njoftimit për aktvendimin përfundimtar. Nëse aplikanti i përzgjedhur nuk paraqitet brenda afatit të përcaktuar në ftesën për lidhjen, përkatësisht nënshkrimin e kontratës, Qyteti i Shkupit do të caktojë një afat të ri që nuk mund të jetë më i gjatë se 5 (pesë) ditë nga dita e pranimit të njoftimit për afatin e ri. Nëse edhe në afatin e ri nuk paraqitet dhe nuk nënshkruan kontratën, do të konsiderohet se ka hequr dorë nga linja e caktuar dhe aktvendimi i miratuar do të anulohet dhe do të arkëtohet garancia e dorëzuar për pjesëmarrje në shpallje publike.

Numër **08-2324/1**  
Shkup

**Kryetarja e Qytetit të Shkupit**  
**Danela Arsovska**